

EDMOND MALAJ**PRANIA DHE VEPRIMTARIA E KLERIT SHQIPTAR
NË RAGUZË GJATË MESJETËS****Dy fjalë hyrëse**

Gjatë Mesjetës së Vonë (shek. XIV-XV), por edhe më parë gjatë shek. XIII, kemi një prani gjithnjë e më të shpeshtë të klerikëve katolikë shqiptarë në trojet e Republikës së Raguzës. Klerikët shqiptarë i gjejmë nëpër manastire, famulli, katedrale dhe nëpër kisha të ndryshme, qoftë në ato më të rëndësishmet apo në ato më pak të rëndësishme. Madje, priftërinjtë shqiptarë depërtojnë edhe në rangjet më të larta brenda vetë Kryeipeshkëvisë së Raguzës, ku në vitin 1383 kemi të dokumentuar si kryeipeshkëv të Raguzës, Andrean nga Durrësi.¹ Në gjysmën e dytë të shek. XIV, numri i klerikëve katolikë shqiptarë bëhet akoma edhe më i madh dhe kjo bie menjëherë në sy nëpër dokumentet e kohës.

Studiuesja gjermane Irmgard Mahnken vëren në Raguzë në vitin 1399 një koloni të madhe priftërinjsh drishtjanë, të cilët ishin larguar për shkak të rrezikut turk.² Priftërinjtë shqiptarë mesa duket kishin filluar të shkonin aty me shumicë qysh gjatë kohës së murtajës që kishte rënë në vitin 1348 dhe nga ky vit deri më 1350 gjenden 24 priftërinj shqiptarë shekullarë: 7 nga Drishti, 7 nga Ulqini, 4 nga Pulti, 2 nga Tivari, 1 nga Shkodra, 1 nga Baleci, 1 nga Shën Shirqi, 1 nga Spasi dhe 4 të tjerë të specifikuar si priftërinj shqiptarë (*arbanenses*), pa të dhëna për kongregacionet e tyre.³ Shtatë priftërinjtë nga Drishti gjendeshin

¹ *Copioso Ristretto degli Annali di Rausa*, di Giacomo di Pietro Luccari. Venetia: At instantia die Antonio Leonardi 1605, f. 174.

² “Statutet dhe urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit”, botuar nën kujdesin e Dr. Viktor Novak dhe Dr. Emilian Shuflaj, në *Gjurmime Albanologjike*, Seria e Shkencave Historike nr. 1-1971, Prishtinë: 1972, f. 48.

³ Milan von Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im katholischen Damme”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer

kryesisht nëpër manastiret raguzane.⁴ Po, r cilat ishin shkaqet apo arsytet e ardhjes së priftërinjve shqiptarë në Raguzë? Ato mund të kenë qenë të shumta, por ne këtu do të përmendim tri më kryesoret:

1. Prania e sekteve dhe lëvizjeve heretike të cilat kishin vënë në rrezik katolicizmin;
2. Murtaja;
3. Turqit.

Me interes është që të japim disa të dhëna të përgjithshme rreth pikës së parë, pra lëvizjeve heretike dhe rrezikimit nga ato të katolicizmit, për mbrojtjen e të cilit dhanë kontributin e tyre edhe klerikët shqiptarë. Republika e Raguzës i përkiste botës perëndimore katolike dhe ishte besnike ndaj Papës, dhe si e tillë ishte promotore e katolicizmit, megjithëse, siç do ta shohim edhe më poshtë, në punët e saj shekulare administrative dhe në jetën politike i përjashtonte personat që i përkisnin hierarkisë kishtarë.⁵

Raguzanët në territorin e tyre nuk e toleronin ortodoksinë, të cilës i përkisnin sllavët që ishin komshinjtë e tyre, që konsideroheshin si skizmatikë dhe sjellja e raguzanëve ndaj tyre ishte qoftë toleruese dhe e distancuar, qoftë refuzuese duke arritur deri në persekutim.⁶ Këtu kemi të bëjmë me një princip të respektuar anembanë nëpër Evropë që ishte “*cuius regio, eius religio*” (e thënë afërsisht: Religjioni i një vendi, varet nga përkatësia fetare e atij që sundon), i cili doli si me këtë përkufizim për herë të parë në Paqen fetare të Augsburgut (*Augsburger Religionsfriede*),⁷ por që si princip ka ekzistuar përherë. Përsa i përket kësaj pati edhe përjashtime nëpër disa zona siç ishte p. sh. Konavle, ku

Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 265; Irmgard Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern während des Mittelalters. Randbemerkungen zur Problematik der balkanologischen Forschung”, në *Beiträge zur Südosteuropa-Forschung*. Anlässlich des I. Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26. VIII. – 1. IX. 1966. Arbeitskreis Südosteuropa-Forschung bei der Deutschen Forschungsgemeinschaft. München: Trofenik 1966, f. 367.

⁴ Po aty.

⁵ Zdenka Janeković Römer, “Gradation of Differences: Ethnic and Religious Minorities in Medieval Dubrovnik”, në *Segregation - Integration - Assimilation: Religious and Ethnic Groups in the Medieval Towns of Central and Eastern Europe*, eds. Derek Keene, Balász Nagy, Katalin Szende. London: Ashgate 2009, f. 125-126.

⁶ Po aty, f. 126.

⁷ *Dtv-Atlas zur Weltgeschichte*. Karten und chronologischer Abriss. Von den Anfängen bis zur Französischen Revolution. Band 1. 24. Auflage. München: dtv 1990, f. 235.

banorët u lejuan që të mbanin besimin e tyre dhe të jetonin sipas tij, që nga viti 1419.⁸ Kjo ndodhte, ngaqë Republika e Raguzës e kishte si zakon që të shmangte rebelimet dhe shqetësimet që mund të krijoheshin.⁹

Raguzë mori masa për mbrojtjen e Katolicizmit dhe për restaurimin e tij, ngaqë lëvizjet heretike, si *manikejt* dhe *patarenët* kishin gjetur tashmë akses edhe në territoret e kësaj republike. Këtu qysh prej shek. IX kishin depërtuar sidomos *arianët* dhe *patarenët*, një prani e madhe e të cilëve vihej re në Stanjo, që pothuajse po rrezikonte ekzistencën e katolicizmit brenda republikës.¹⁰ Në lidhje me shtimin e *patarenëve* në trojet raguzane, studiuesja kroate Z. Janeković Römer thotë që ata u rritën në numër edhe nga tregtia e skllëvërve, sepse pjesa më e madhe e skllëvërve që shiteshin në Raguzë ishin *patarenë* dhe *boshnjakë*¹¹, që i përkisnin herezisë *bogomile*, të cilët më parë nuk kishin qenë skllëvër¹².

Megjithatë, heretikët (*patarenë**, *bogomilë* etj.) e kishin një mënyrë shpëtimi. Nëpërmjet konvertimit në katolicizëm "*de contrata catholica*" dhe pagëzimit, statusi i skllavit shfuqizohej menjëherë dhe ata bëheshin të lirë, përndryshe tregtari që tregtonte dhe mbante si skllëvër katolikë, nëse zbulohej nga organet gjobitej dhe burgosej.¹³ Me anë të masave të ndërmarra kryepeshkvinjtë e Raguzës ia dolën më në fund ta pastronin vendin nga lëvizjet e ndryshme alternative (heretike) duke e mbështetur katolicizmin gjithnjë e më fort me anë të masave që përmendëm më

⁸ Z. Janeković Römer, "Gradation of Differences...", f. 127.

⁹ Po aty.

¹⁰ Julius Krone, *Frà Dolcino und die Patarener: historische Episode aus den piemontesischen Religionskriegen*. Mit kirchen- Kultur- und rechtsgeschichtlichen Erläuterungen nach Originalquellen, Julius Krone, Mitgleide der historisch-Theologischen Gesellschaft in Leipzig. Leipzig: T. O. Weigel 1844, f. 25, ref. 1.

¹¹ Z. Janeković Römer, "Gradation of Differences...", f. 127.

¹² Po aty.

* Në lidhje me *patarenët* duhet të thuhet këtu që qarqet e larta të tyre i detyruan raguzanët në menyra të ndryshme që të mbanin marrëdhënie të mira me ta. Personalitete të larta të hierarkisë *patarene* e vizitonin Dubrovnikun shpesh herë si emisarë dhe të sunduesve *boshnjakë*. Qeveria raguzane i priste ata mirë dhe me nderimet e duhura, megjithatë ata nuk lejoheshin të hynin lirshëm në qytet, përveçse me lejen e qeverisë. Edhe tregtarët raguzanë bënë tregti pa hezitim me *patarenët* dhe kur ata udhëtonin në bosnjë, shtëpitë e *patarenëve* (*hižas*) u shërbenin atyre si hane. Megjithatë, edhe pse *patarenët* toleroheshin si komshinj që jetonin përtej kufirit, në Raguzë ata nuk lejoheshin të banonin. *Shih*: Z. Janeković Römer, "Gradation of Differences...", f. 128-129.

¹³ Z. Janeković Römer, "Gradation of Differences...", f. 128.

sipër.¹⁴

Pra, mbështetja e katolicizmit dhe rikatolizimi, kjo duhet të ketë qenë edhe arsyeja kryesore, e cila bëri që të lejoheshin të vinin gjithnjë e më tepër klerikë katolikë nga vende përreth dhe që çoi në mënyrë indirekte edhe në ekspandimin e priftërisë katolike shqiptare në shek. XIV e më vonë. Për arsyet që përmendëm më sipër nevojiteshin atje priftërinj katolikë dhe këta u gjetën në vendet përreth, si në Itali, në vendet dalmate dhe arbërore.

Në këtë artikull do të paraqesim të dhëna mbi praninë dhe aktivitetin e klerikëve katolikë shqiptarë në territorin e Republikës dhe do të përqendrohemi kryesisht në shek. XIV. Kjo tematikë në fakt është shumë e gjerë dhe nuk mund të mbulohet vetëm me një artikull, por këtu kemi bërë një përzgjedhje nga të gjitha ato të dhëna që kemi në dispozicion. Përsa i përket emrave të klerikëve, ata jepen në të shumtën e rasteve vetëm me emrin e parë (pra pa mbiemër), apo me emrin e thirrjes ose nganjëherë këtyre emrave u vihet si shtojcë edhe origjina, kështu që nuk është aspak e lehtë të vërtetohet se bëhet fjalë për të njëjtin person, kur përmenden dy emra të njëjtë.

Këtë problem në regjistrimin e emrave të klerikëve shqiptarë e vënë re edhe studiues të tjerë.¹⁵ Pra në pjesën më të madhe të tyre vendoset si mbiemër vendi i origjinës duke na lënë në errësirë përkatësinë e tyre familjare ose farefisnore. Le t'u hedhim tani një vështrim më të detajuar këtyre priftërinjve shqiptarë që gjendeshin në Raguzë.

Klerikë shqiptarë pa përcaktim të vendit të origjinës

Në vitin 1348 përmendet dom Pjetri Shqiptar (*Dompnus Petrus albanensis*) nga këshilli i vogël u caktua si presbiter i Manastirit të Stanjos me një rrogë prej 10 perperësh në vit dhe përveç kësaj lejohej të kishte edhe vreshtin e këtij manastiri.¹⁶

¹⁴ J. Krone, *Frà Dolcino und die Patarener...*, f. 25, ref. 1.

¹⁵ Si të tillë mund të përmendim Irmgard Mahnken, e cila e thekson këtë mangësi edhe në punimin e saj të cituar më poshtë në: I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern...", në *Südosteuropa-Forschung*, f. 367, ref. 58.

¹⁶ "*Dompnus Petrus albanensis in dicto consilio factus fuit presbiter monasterii de Stagno cum salario ypporum x in anno et quod habere debeat vineam dicti monasterii.*" *Monumenta Ragusina*. Liber Reformationum Tomus II. A. 1347-1352. 1356-1360. Additamentum a. 1301-1305, 1318.1325-1336. Zagabriae: Sumptibus

Klerikët nga Tivari

Nga Tivari shfaqen nëpër dokumente këta klerikë. Në vitin 1352 përmendet frati Domanja i Tivarit, si abat i Manastirit të Lakromës.¹⁷ Gjatë viteve 1370-1385 në Raguzë përmendet edhe presbiteri Gjoni, i biri i Pal Grubetiçit (*presb. Johannes qu. Pauli Grubetich de Antibaro*) (emri i tij jepet në testamentin e tij edhe në formën Grubsich dhe Grusipch).¹⁸ Tek vepra e Milan Shuflait “Situata të Kishës në Shqipërinë Paraturke”¹⁹ flitet për një frat dominikan që kishte qenë prior i dominikanëve në Raguzë dhe arrin të ngjitet në vitin 1363 (sipas Theiner, më 1365)²⁰ në fronin kryepeshkvnor të Tivarit²¹, që ishte sigurisht shqiptar²² (dhe jo raguzan, siç thotë Farlati²³). Ishte murg i atij lloji që e hasim në Raguzë në fillim të shek. XV, ku dy fretër rregulltarë shqiptarë në shenjë hakmarrjeje u përpoqën të ndiznin me shigjeta manastirin e tyre.²⁴ Ky ishte Gjoni, kryepeshkvi i Tivarit (*Johannes IV Archiepiscopus Antibarensis*), i cili mbajti lidhje aktive me fisnikët e lartë shqiptarë veriorë, me Balshajt e Zetës, me Dukagjinët e Lezhës, me zotërinjtë e Pultit e me familjen Suma në bregun verior të Bunës dhe bënte çfarë të donte në Shqipërinë Veriore.²⁵ Emërimet papnore që nuk i pëlqenin atij,

Scientiarum et Artium 1882, f. 35. (=Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium. Volumen XIII) (më tej: *Liber Reformationum ...*, II (1347-1352...)).

¹⁷ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 369.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Shih në lidhje me këtë klerik tek: Milan fon Shuflaj, *Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke. Zona e depërtimit ortodoks në “digën” katolike*, Botim II, Shqip nga Edmond Malaj, Shkodër: Botime Françeskane 2016, f. 76-78.

²⁰ *Vetera monumenta Slavorum meridionalium historiam illustrantia* maximam partem nondum edita ex tabulariis vaticanis deprompta collecta ac serie chronologica disposita ab Augusto Theiner. Tomus Primus: Ab Innocentio PP. III. usque ad Paulum PP. III. 1198-1549. Romae: Typis Vaticanis 1863, nr. 339.

²¹ *Illyrici Sacri. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis*. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë, Prishtinë: Arbi 2004) (më tej: D. Farlati, *Illyrici Sacri VII*).

²² M. Shuflaj, *Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke ...*, f. 76.

²³ “*Erat patria Ragusinus*”, D. Farlati, *Illyrici Sacri VII*, f. 78.

²⁴ M. Shuflaj, *Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke ...*, f. 76.

²⁵ Po aty.

nuk i merrte parasysh dhe ndërhynte në njësitë administrative kishtare të Durrësit, të Arbrit dhe të Lezhës.²⁶

Më në fund, pas shumë e shumë ankesash nga të dëmtuarit, Kuria e zbuloi shkaktarin e vërtetë të kësaj gjendjeje të keqe që ishte Gjoni (Johann), kryeipeshkvi i Tivarit, të cilit iu hoq titulli në korrik të vitit 1371,²⁷ dhe për dënim u transferua në vitin 1373 në Cezarea (Kajserije) të Palestinës, ndërsa administrimi i arkidioqezës iu besua ipeshkvit të Drishtit dhe patricit të këtij qyteti *Johann de Lepore*.²⁸ Megjithatë e gjithë kjo në praktikë nuk u zbatua aspak, ngaqë kryeipeshkvi i Tivarit e kundërshtoi urdhrin e Papës dhe qëndroi në Tivar, kështu që Papa që i detyruar t'u drejtohej drejtpërsëdrejti zotërinjve të Zetës²⁹ dhe në vitin 1374 disa herë edhe Karl Topisë, me qëllim që t'i hiqnin mbështetjen mitropolitit të qortuar zyrtarisht.³⁰ Më në fund, prelati i paskrupullt që i detyruar të ikte nga Tivari.

Në vitin 1388 e gjejmë atë në Regjio të Italisë së Sipërme dhe më vonë në Raguzë, ku vdiq pas vitit 1393³¹ dhe u varros në Manastirin e Dominikanëve.³²

Në vitin 1376 përmendet edhe një person tjetër me emër të ngjashëm si Gjoni i mësipërm. Ai është Gjon Sllavi, presbiter në Grausio (*presb. Johannes sclauicus presb. in Grausio*),³³ i cili duhet të ketë qenë person tjetër. Ky njihet edhe me emrin presbiteri Gjon Sllavi i Brenos (*presb. Johannes sclauicus de Breno*) ngaqë emri i tij del në të njëjtin dokument me këtë formë.³⁴

Më vonë emri i tij na del sërish në vitin e murtajës 1391, porse me një variant tjetër të emrit, si “*don Çoane Capellano de Grauossa*” që gjendet i shkruar në testamentin e tij të bërë po atë vit. Në atë testament përmendet edhe emri i vëllait të tij *Nixa* në moshë fëmijore, të cilin ai ia

²⁶ *Po aty*.

²⁷ *Vetera Monumenta Slavorum Meridionalium Historiam Illustrantia ...*, Tomus Primus, f. 277.

²⁸ M. Shufflay, *Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke...*, f. 78.

²⁹ A. Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum ...*, 1, nr. CCCLXXXV.

³⁰ *Po aty*, f. 288, 292.

³¹ M. von Šufflay, “Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. ...”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, f. 247.

³² D. Farlati, *Illyrici Sacri VII*, f. 80.

³³ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 369.

³⁴ *Po aty*.

kishte dhënë në kujdestari dy priftërinjve që kishin të njëjtin emër, pra presbiterit Dhimitri nga Tivari (*Dymtrius Anibarensis*) dhe dom Dhimitri (*dom Dymitris*) gjatë kësaj kohe 1390/91, ata ishin gjithashtu dëshmitarë në bërjen e testamentit të tij.³⁵

Më tej përmendet edhe at Gjergji nga Tivari i cili para se të arratiset në Dubrovnik në vitin 1382, kishte qenë për pelegrinazh në Tokën e Shenjtë.³⁶

Po gjatë vitit të murtajës 1391, në testamentin e Marusës, gruas së një farë Luxe Benvinjuta (1391, *Marussa uxor qu. Luxe de Benuignuta*) përmenden edhe dy priftërinj nga Tivari, të cilët janë presbiteri Dominko Kuriace i Tivarit (*pre Domincho Curiace d'Antivaro*) dhe presbiteri Andrea de Mako i Tivarit (*pre Andrea de Macho d'Antivaro*).³⁷

Më tej, përmendet dom Dhimitri nga Tivari, që është banues në Raguzë dhe që më 11 tetor të vitit 1400 del dëshmitar për testamentin e Radulles, gruas së Pribislaut.³⁸ Më 16 dhjetor të vitit 1413 përmendet ndër disa fretër françeskan shqiptarë frat Marini nga Tivari (*Frater Marinus de Antibarō*) që i përkiste kapitullit të kuvendit françeskan të Raguzës.³⁹

Klerikët nga Roteci dhe nga Spici i Tivarit

Nga Roteci përmenden në vitin 1372 prifti Marinus, testamenti i të cilit është i regjistruar në datën 30. 3. 1372, kurse nga Spici që gjendet në afërsi të Tivarit ishte një farë presbiter Gjergj Nigri i Spicit (*presb. Georgius Niger de Spisso*), i cili jetonte në Raguzë gjatë viteve 70 dhe që përmendet në vitin 1377.⁴⁰

³⁵ Po aty, f. 369.

³⁶ Etleva Lala, "Klerikët Shqiptarë gjatë Mesjetës në arkivat e Dubrovnikut. Arratisjet nga Shqipëria dhe Karriera në qytetet e Bregdetit Dalmat. Zbulime befasuese nga Arkivat e Dubrovnikut.", në *Rilindasi*, Viti III/Nr. 10 [Suplement i gazetës *Shqiptarja.com*, Viti III - Nr. 56, Tiranë: 10.03.2013, f. 15.

³⁷ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern...", në *Südosteuropa-Forschung*, f. 369.

³⁸ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të Shek. XV*, vëll. I. (1400-1405), përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1987, nr. 71, f. 150.

³⁹ I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern...", në *Südosteuropa-Forschung*, f. 369.

⁴⁰ Po aty.

Klerikët nga Ulqini

Nga qyteti i Ulqinit shfaqen si të pranishëm në Raguzë klerikët e mëposhtëm. Si të parin po përmendim At Nikolla Markun, i cili ishte arratisur nga Ulqini pa dhënë shkaqet e kësaj ikjeje dhe gjendet i dokumentuar në Raguzë në vitet 1349 dhe 1354.⁴¹

Në vitin 1352 përmendet presbiteri don Marinus de Dolcigno, i cili e pajton në punë vëllanë e tij për 20 perperë rrogë dhe veshje tek Priboe de Vladimiro.⁴² Marinus përmendet edhe në lidhje me një dokument trashëgimie, të cilin e motra e kapelanit dom *Phylippe de Martinussio* (de Mence) e merr për prikën e saj nga *Petrus de Petragna* në vitin 1368.⁴³

Gjatë hulumtimit tonë rreth pranisë së klerikëve shqiptarë në Raguzë gjatë Mesjetës, nëpër studime dhe dokumente na paraqitet një person i quajtur Marinus de Dulcinio, i cili rezulton i pranishëm që në vitin 1352 në Dubrovnik.⁴⁴

Më vonë kemi akoma edhe një person tjetër po me këtë emër, Marinus de Dulcinio që nuk mund të jetë i njëjti person dhe që përmendet në vitin 1380-92 si banues në Dubrovnik. Ky duhet të ketë qenë me siguri kryepeshkvi i mëvonshëm i Tivarit, i cili ishte në krye të kësaj kryepeshkvie nga viti 1396 deri në vitin 1420 për të cilin po japim disa të dhëna biografike. Vitin e tij të lindjes nuk e dimë dhe nuk dimë asgjë rreth rinisë dhe formimit të tij klerikal. Të dhënat rreth tij fillojnë me hyrjen në shërbimin diplomatik për Balshjat.

Marinus de Dulcineo kishte marrëdhënie me Gjergj Strazimir Balshën II⁴⁵ dhe i shërbente atij në çështje diplomatike delikate dhe të rrezikshme.⁴⁶ Ai e kishte vizituar Raguzën për herë të parë pikërisht si ambasador i Balshës, dhe duke qenë shumë i dashuruar pas qytetit bëri

⁴¹ E. Lala, "Klerikët Shqiptarë ...", f. 14.

⁴² I. Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern ...", në: *Südosteuropa-Forschung*, f. 368. Priboe de Vladimiro bënte pjesë tek ai rreth personash që më vonë do të formonin vëllazërinë e Shna Ndou (Antunini).

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ M. von Šufflay, "Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. ...", në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, I, f. 255.

⁴⁶ Giuseppe Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi. Studi storici documentati del Prof. Giuseppe Gelcich*. Spalato: Tipografia Sociale Spalatina (G. Laghi) 1899, f. 179, 180, ref. 3.

kërkesë që të mund të banonte aty, gjë që iu lejua dhe më vonë ai përfitoi edhe titujt dhe cilësitë e qytetarisë raguzane.⁴⁷ Ai nuk u kthye nën shërbimin e Balshës, dhe kështu Balsha që i detyruar që të gjente dikë tjetër për marrëdhëniet e tij me Raguzën. Që në fillim të qëndrimit të tij në Dubrovnik ai dha kontribut në diplomacinë e kësaj Republike. Më 16 janar të vitit 1380 ai që dërguar nga Këshilli i Raguzës si ambasador tek Mbreti i Bosnjës dhe po atë vit më 29 korrik u dërgua nga rektori i Raguzës dhe nga këshilli i lartpërmendur edhe në Ulqin për të bërë të mundur kthimin e një brigandine gjenoveze.⁴⁸

Me qëllim që të përmbushte kushtet, për të fituar nënshtetësinë raguzane, ku ndër të tjera, duhej të kishe edhe para, atij iu desh që t'ia shiste për 50 dukatë shtëpinë e vet prej guri, në të cilën banonte (*domum lapideam quam habet in Dulcinio*), vëllezërve Vallius dhe Marko Blasius, të cilët i dhanë atij fillimisht 29 dukatë. Ndërsa ai u premtoi atyre, se do t'u jepte edhe një certifikatë noteriale pronësie, sapo ai të kishte të gjithë shumën, dhe deri atëherë ata nuk lejoheshin as të qëndronin, as të banonin e as ta kishin në pronësi këtë shtëpi deri sa t'ia paguanin Marinit të gjithë shumën prej 50 dukatësh.⁴⁹

Gjatë qëndrimit të tij në Raguzë ai pati një letërkëmbim të fshehtë me Mbretin Tvërtko të Bosnjës, nga i cili përfitoi si pronë fshatin e vogël Uskoplje të Konavljës në Raguzë, gjë që ishte e ndaluar dhe kundër ligjeve të Raguzës⁵⁰, Kjo u zbulua dhe me gjithë përpjekjet për ta dënuar, kryeipeshkvi deklaroi në Dubrovnik se nuk mund ta ndëshkonte, sepse për këtë nuk kishte bazë ligjore në ligjin kanonik.⁵¹ Megjithatë ai u dënua me pesë vite dëbim⁵², gjatë të cilave nuk lejohej të shkelte në territorin e Republikës, sepse vendi në fjalë ndodhej brenda disa kufijve të ndaluar,

⁴⁷ *Po aty*, f. 75.

⁴⁸ Savo Marković, "Marin Ivanov, barski nadbiskup 1395-1420", në *Matica. Časopis za društvena pitanja, nauku i kulturu*, Godina XIII, broj 50/ Ljeto 2012, Cetinje, Podgorica: 2012, f. 190.

⁴⁹ *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 410. (më tej: AAlb, II)

⁵⁰ AAlb, II, nr. 537, ref. 1.

⁵¹ G. Gelcich, *La Zedda e la dinastia dei Balšidi...*, f. 176; Savo Marković, "Marin Ivanov, barski nadbiskup 1395-1420", në *Matica, Časopis za društvena pitanja, nauku i kulturu*, Godina XIII, broj 50/ Ljeto: 2012 (Cetinje, Podgorica: 2012), f. 191.

⁵² AAlb, II, nr. 537, ref. 1.

por dhe qytetarëve të Raguzës nuk u lejohej që të merrnin ato prona nga një sundimtar i huaj.⁵³ Gjergj Strazimir Balsha kishte nevojë për shërbimet e tij, kështu që më 10 gusht të vitit 1395 i dërgoi një kërkesë Këshillit të Vogël të Raguzës që të falej dom Marini i Ulqinit, ose të paktën të lejohej të kalonte nëpër det ose nëpër tokë, por pa hyrë nëpër qytetin e Raguzës.⁵⁴

Ai përmendet në vitin 1395 edhe si kanonik i Ulqinit.⁵⁵ Një vit më vonë, më 1396 ai bëhet argjipeshkëv i Tivarit, duke u shuguruar si i tillë nga papë Bonifaci IX, si *Marinus II, Archiepiscopus Antibarensis XXI*, më 24 janar të vitit 1396.⁵⁶ Në vitin 1420 ai gjendet përsëri në Raguzë, ku lë edhe testamentin e tij të fundit të përpiluar më datë 12 janar 1420.⁵⁷

Në vitin 1391 bëhet fjalë për një person me emrin Marko de Dolcigno, i cili në testamentin e tij përmend të vëllain dom Marinin, për të cilin jemi të mendimet se bëhet fjalë po për të njëjtin person. Ky Marku gjendet i shënuar edhe në Regjistrin e Shoqërisë së Shna Ndout (Antunini) me emrin “Marcoç de Giuan Dolcino”, përveç kësaj dom Marini përmendet edhe në vitin 1374 si “*presb. Marinus de Dulcinio*”, në vitin 1383 si “don Marin de Dolcigno” dhe më 1387 si dom “Marinin të birin e një farë Gjonit nga Ulqini” (*dom Marinus qu. Johannis de Dulcinio*) që mund të jetë i njëjti person mbase jo ai i vitit 1368.⁵⁸

Rreth vitit 1388-1391 përmendet një farë dom Nixa de Dolcigno, për të cilin Mahnken është e mendimit se mund të jetë i njëjti person me dom Nikollë (don Nikola) të vëllain e Anës, gruas së Bokoe Veselkoviqit (*Aniçe, uxor Bogoe Veselchouich*), e cila në vitin 1388 i lë atij me testament pronat e patundshme në Ulqin.⁵⁹ Në vitin 1391 përmendet don Pelegrinus de Dulcinio i cili disa vite më vonë më 1394 përmendet sërish,

⁵³ Po aty.

⁵⁴ AAlb., II, nr. 537.

⁵⁵ Šime Ljubić, *Listine o odnašnjih između južnoga Slavenstva i Mletačke republike*. Skupio i uredio Šime Ljubić, Pravi Clan Jugoslavenske Akademije znanosti i umjetnosti ITD, Knjiga IV, Od godine 1358 do 1403, Zagreb: Jugoslavenska Akademija Znanosti I Umjetnosti 1874, f. 350; AAlb II, nr. 542; shih edhe: I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 368.

⁵⁶ D. Farlati, *Illyrici Sacri VII*, f. 84.

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 368.

⁵⁹ Po aty.

por që atë vit ishte tashmë i vdekur.⁶⁰

Nëpër dokumente përmendet edhe një prift ulqinak, i cili ishte në shërbimin diplomatik të Raguzës. Ky ishte prifti Marin Buçinjolo (Marino Bucignolo), të cilin e gjejmë nëpër dokumente raguzine të vitit 1388. Raguza ishte e interesuar vazhdimisht për informacione mbi avancimin e turqve edhe në trojet arbërore, dhe në një rast të tillë, më 10 gusht 1388 dërgon edhe Buçinjolon si ambasador të saj tek Gjergj II Strazimir Balsha.⁶¹

Në vitin 1390 kemi të dokumentuar edhe priftin dom *Johannes de Bogde*⁶², i cili përmendet dokumentuar edhe në një libër të Sexteriumit në kishës katedrale të Shën Vlashit të Raguzës. Aty është shënuar që më datë 10.04.1442 Kuria, i shet dom Johannes de Bogde de Dulcigno një shtëpi me çmimin prej 200, të ndodhur sipër terrenit të kryepeshkvisë në afërsi të shtëpisë së një farë Jurchi Fabri.⁶³ Edhe pse ndërmjet përmendjes së emrit të tij ka një diferencë kohe prej 50 vitesh, jemi të mendimit që bëhet fjalë për të njëjtin person. Aty përmenden edhe persona të tjerë nga Ulqini që kanë të bëjnë me shitjen e kësaj shtëpie dhe që mund të kenë shërbyer si prokuratorë, ata janë Gjoni i biri i Marinçe Vlashit nga Ulqini (*Johannis filii Marinçe Blaxii de Dolcigno*) dhe Pjetër Nika dhe Gjoni, të bijtë e Val Vlashit nga Ulqini (*Petroe Nichi et Johannis filiorum Valli Blaxii de Dolcigno*).⁶⁴

Klerikët nga Shasi

Nga Shasi (Suacium, Svač) gjendeshin në Raguzë klerikët e

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Gjon Berisha, “Agjenti dhe tregtari Filip Barelli në oborrin e Balshajve: influenza e tij në gjysmën e dytë të shek XIV”, në *Studime Historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2018, f. 43.

⁶² I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 368.

⁶³ Aty shënohen edhe të dhëna të tjera në lidhje me vendodhjen e shtëpisë dhe me kufijtë e saj me personat e tjerë dhe krahas tij përmenden edhe persona të tjerë nga Ulqini që kanë të bëjnë me shitjen e kësaj shtëpie: “...*super terreno Archiepiscopatus prope domum Jurchi Fabri confinat a monte cum domo Novach vendar, a ponente cum domo Givichi Rastien mediante muro cumunali, a pelago cum domo Radosavo Dudaou et a levante cum via comunis.*” Dokument: Marrë nga projekti: Dubrovnik: Civitas et Acta Consilliorum.

<https://ducac.ipu.hr/project/wp-content/uploads/Saint-Blaise-SEXTERIUM.pdf>
(4.10.2019) (më tej: Liber 9, fol. 72r/74).

⁶⁴ Po aty.

mëposhtëm. Në vitin 1363 përmendet diakoni Tomko i Shasit (diac. Tomcho de Suacio), atë e gjejmë sërish në vitin 1371 si një dëshmitar testamenti⁶⁵ për klerikun Pjetër nga Shashi (presb. Petrus de Suacio), i cili në fund të janarit të vitit 1372 nuk jetonte më, dhe po në vitin 1372 vdes edhe piriti Gjoni nga Shasi (*presb. Johannes de Suasio*).⁶⁶

Klerikët nga Shkodra

Edhe nga Shkodra kemi të dokumentuar disa klerikë. Si të parin mund të radhisim këtu at Shtjefnin nga Shkodra i cili më 30 prill të vitit 1300 rezultoi si vikar i i kuvendit françeskan “Male Braće” në Dubrovnik.⁶⁷ Në Kres kemi at Mëhillin, i cili kishte ikur nga Shkodra në vitin 1329 dhe kishte vdekur në vitin 1350. Po ashtu në atë kuvend gjejmë të dhëna edhe për at Ndreun nga Shkodra në vitin 1347 që ishte gardian i këtij kuvendi dhe që kishte ikur në gusht të vitit 1345, kurse si gardian emërohet në vitin 1346 dhe më 23 maj të vitit 1354.⁶⁸

Në kuvendin e urdhrit françeskan shfaqet në vitin 1348 si kustos (*custos ordenin fratrum minorum*)⁶⁹ edhe at Dhimitri nga Shkodra (*frater Dimitri de Scutaro*), i cili mesa duket kishte ikur nga vendlindja në vitin 1339 për shkak të frikës nga hakmarrja, sepse njëri nga vëllezërit e tij, Mëhilli, kishte vrarë një kushëri të ipeshkvit të Shkodrës.⁷⁰ Sipas studiueses E. Lala, këtë françeskan e gjejmë në vitin 1354 si ipeshkëv të Stefanikës⁷¹ dhe më vonë dhe si kryeipeshkëv të Durrësit⁷² në vitin 1369,

⁶⁵ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 369.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 14.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ AAlb II, nr. 38.

⁷⁰ E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 14.

⁷¹ Për këtë vit në ipeshkvinë e Stefaniakës nuk kemi asnjë të dhënë tek Farlati. Po ashtu tek ky autor të dhënat mungojnë për periudhën nga shekulli IX deri në vitin 1366. D. Farlati, *Illyrici Sacri VII*, f. 405.

⁷² Në vitin 1369 te Farlati nuk jepen të dhëna për vendosjen e Dhimitrit në argjipeshkvinë e Durrësit. Më përpara në këtë argjipeshkvi, në vitin 1349 që vendosur frati françeskan Antoni nga Alessandria e Italisë, për të cilin nuk dimë se deri kur qëndroi aty. Më pas në vitin 1370 flitet për një ipeshkëv të ri në Durrës, që duhet të ishte nga Urdhri Françeskan. Sipas Farlatit bëhej fjalë për katër ipeshkvi të caktuar nga Papa Urbani, të cilët ishin françeskanë dhe njëri prej tyre ishte edhe argjipeshkvi i

ku sipas të gjitha gjasave ai kishte zgjidhur problemet me gjakmarrjen që kishte pasur në vitin 1339.⁷³ Tek Farlati në lidhje me këtë person nuk gjejmë të dhëna. Më tej nëpër dokumente hasim edhe priftin Marinin nga Shkodra (*presb. Marinus de Scutaro*) i cili përmendet në vitin 1371.⁷⁴

Më tej, në vitin 1389 përmendet dom Domeniku nga Shkodra (dom Dominicus de Scutaro), kurse në vitet 1389-1398 dom Andrea nga Shkodra që ishte kapelan i kishës së Shën Dominikut (*don Andrea de Scutaro, capellanus de s. Domino*) dhe që lë edhe një testament.⁷⁵ Në vitin 1385, nëpër burime bëhet fjalë edhe për at Shtejfnin nga Shkodra që ishte arratisur në vitin 1382 dhe në vitin 1385 figuron si profesor teologjie dhe filozofie në Gjumnazin e Dubrovnikut.⁷⁶

Gjatë viteve 1388-1392 përmendet një farë dom Dhimitri, i vëllai i Barbaras nga Shkodra, që ishte e shoqja e njëfarë Nikollë farkëtarit (*don Dyrnitri (Dymiter) ... Barbara de Scutaro uxor qu. Nicole fabri*), që ndoshta është identik me Dhimitrin e Shkodrës (dom Dimitri de Scutaro), i cili njihet në vitin 1391 dhe si “prift sllav” (presbiter sclavicus) në Brenno.⁷⁷ Barbara kishte edhe një djalë të quajtur po ashtu dom Dhimitër (*don Dymitrio/ Demetrius*), i cili në vitin 1391 ishte tashmë i vdekur ndoshta viktimë e murtajes që kishte rënë në atë kohë, dhe në atë vit (1391) ajo bëri testamentin e saj.⁷⁸

Në një dokument të datës 16 dhjetor të vitit 1413 (Dubrovnik) jepen disa emra fretërish françeskanë shqiptarë ndër të cilët nga Shkodra janë frat Andrea, frat Pali nga Shkodra, frat Gjoni nga Shkodra dhe frati Andrea nga Shkodra ...” dhe që bënin pjesë në kapitullin e kuvendit françeskan të Raguzës.⁷⁹

ri i Durrësit. Pra, nuk përjashtohet mundësia që ky kryeipeshkëv i panjohur të ketë qenë at Dhimitri nga Shkodra. D. Farlati, *Illyrici Sacri VII*, f. 367-368.

⁷³ E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 14.

⁷⁴ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 368.

⁷⁵ Po aty.

⁷⁶ E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 15.

⁷⁷ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 368.

⁷⁸ Po aty.

⁷⁹ “*Frater Andreas. Frater nicholaus de durachio. Frater paulus de scutaro. Frater Marinus de Antibaro. Frater gion de scutaro ... Frater alter Andreas de scutaro ...*” Po aty.

Klerikët nga Drishti

Klerikët drishtjanë, mesa duket e kanë nisur emigracionin për në Raguzë shumë herët dhe marrëdhëniet më të ngushta të ipeshkvisë së Drishtit me kryeipeshkvinë e Raguzës fillojnë që në shek. XII, së pari kur Papa Kaliksti II në një letër të datës 14 tetor të vitit 1122 e deklaroi kishën e Drishtit si Sufragane të Kryeipeshkvisë së Raguzës me kryeipeshkvit raguzin të Dioklesë dhe të Tivarit Geraldus por nuk përmend emrin e ipeshkvit të Drishtit (*emri i ipeshkvit ndoshta Elia*),⁸⁰ e më tej, kur ndër të tjera ipeshkvi i Drishtit Gjoni (Johannes episcopus Drivastensis) i premtoi dhe konfirmoi bindjen e tij ndaj argjipeshkvit të Raguzës, ashtu siç e kishte vendosur Selia Apostolike e Romës. Dhe kjo ndodhi më 14 prill 1199.⁸¹ Në vitin 1317 përmendet një prift nga Drishti, i quajtur Andreas de Drivasto (1317-1334) dhe ishte noter në ishullin Lagosta, por që i përkiste shtresës së patricëve ulqinakë.⁸²

Këtu mund të përmendet rasti i murtajes në mesin e shek. XIV (rreth viteve 1350), për shkak të së cilës shumë drishtjanë ikën në Raguzë por edhe aty nuk gjetën shpëtim sepse epidemia kishte përfshirë të gjithë republikën dhe pakësonte popullsinë ditë për ditë.⁸³ Me këtë rast mund të përmendim dom Nikola Berivoj nga Drishti (*Dompnus Nicola Beriwoy de Driuasto*), i cili paguhet nga disa qytetarë raguzanë për të bërë në vitin 1350 një udhëtim pelegrinazhi për në Romë.⁸⁴ Dhe po të njëjtin vit (1350) kemi të dokumentuar edhe dom Andrean nga Drishti presbiter në Raguzë, i biri i Pjetër Palombos (*Andreas filius Petri, Presbyter Ragusinus*),⁸⁵ i cili ngarkohet për një në pelegrinazh në Romë.⁸⁶

⁸⁰ D. Farlati, *Illyrici Sacri VII...*, f. 235; *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovicus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 81, f. 27 (më tej: AAlb. I) (Tek AAlb., emrin ipeshkvi e ka Elia).

⁸¹ AAlb. II, nr. 118.

⁸² Milan von Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*. Vorgelegt in der Sitzung am 24. April 1918. Wien/Leipzig: Hölder-Pichler-Temsky 1924, f. 78. (=Akademie der Wissenschaften in Wien. Philosophisch-historische Klasse. Denkschriften, 63. Bd, 1. Abhandlung).

⁸³ Klaus Bergdolt, *Der Schwarze Tod: Die Große Pest und das Ende des Mittelalters*. 3. Auflage. München: C. H. Beck 2011, f. 47.

⁸⁴ AAlb. II, nr. 66.

⁸⁵ Po aty, nr. 47.

Megjithatë për pelegrinazhet do të flasim edhe më poshtë.

Në Raguzë në vitin 1369 shfaqet qytetari Nicola de Drivasto, i cili harton testamentin e tij dhe përmend Marusën (Marussa) të bijën dhe të birin, presbiterin Teodor në Ston (*Teodorus f. domni Nicole de Deriuasto, presbyter in Ston*), i cili siç e përmendëm edhe më lart, si mësues shkollë (*magisteru scholarum*), sepse kishte hapur një shkollë.⁸⁷ Për këtë testament ishin dëshmitarë Marini dhe Pali nga Drishti (*Marinus et Paulus de Drivasto*). Po në këtë vit, pra më 1369 del i dokumentuar edhe Dominik Lepore nga Drishti (*Dominicus Leuere de Driuasto*), i cili bashkë me dom Pjetër Sumën nga Drishti, kapelan i Shën Vlashit (*domunus Petrus Suma capellanus sancti Blasii*) i kishin borxh 63 dukatë ari një qytetari të quajtur Palce de Palmota.⁸⁸

Në vitin 1370, përmendet edhe presbiteri Lazri nga Drishti (*Laçaro de Driuasto*),⁸⁹ ndërsa një vit më pas, më 1371 përmendet presbiteri Tanushi (*Thanussius*), që ishte i vëllai i Marusës (Marussa), e bija e *Andre Castrice de Drivasto* dhe bashkëshortja e një farë Çiucho, por që në testamentin e saj përmendet edhe një motër me emrin Russe dhe një vëlla tjetër me emrin *Tuodore*.⁹⁰

Që prej vitit 1371 e deri në vitin 1391 përmendet shumë shpesh presbiteri Demetrius (Dyrnitri) de Drivasto, kurse për vitet 1372/73 presb. Dominçe (Domicus) de Drivasto⁹¹ dhe për vitin 1381 dokumentohen atje edhe Andreas Predimiri Palombo i Drishtit⁹² që i përkiste familjes së njohur Palombo të Drishtit.

Në Raguzë gjejmë në vitet 80 të shek. XIV edhe ish ipeshkvin e Drishtit Gjonin (ipeshkëv i Drishtit nga viti 1360 deri në vitin 1373), dhe më vonë në kryepeshkëvinë e Tivarit, nga viti 1373 papa Gregorin XI.⁹³ Ai i përkiste familjes së njohur Lepore (de Leporibus) nga Drishti dhe ishte i njohur edhe si “*auditor*” dhe “*examinator*” për komunat

⁸⁶ Po aty, nr. 66.

⁸⁷ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 367.

⁸⁸ AAlb. II, nr. 257.

⁸⁹ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 367.

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ Po aty.

⁹² AAlb. II, nr. 376.

⁹³ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 367, f. 237.

dalmatine, “*judices et contractus*”, fisnik i vërtet në Lokrum dhe në Meleda, dhe i njohur si njeri i ditur në Braç dhe Hvar.⁹⁴ Përveç të tjerash ky ipeshkëv ishte i lidhur shumë me Balshajt.⁹⁵

Më 1384 përmendet presbiteri Georgius de Drivasto, i cili kishte vdekur, përveç tij përmendet edhe mbesa Marussa që martohet me den Raychus Rastisich.⁹⁶ Kurse në vitin 1386 dhe 1391 përmendet si presbiter në Raguzë edhe Jakob Svini i Drishtit (*Jacopus de Svinis Drivastensis*).⁹⁷

Më 1388 gjendet nëpër dokumente edhe dom *Michiel barba bianca de Driuvasto*, i cili në Drisht kishte akoma pasuri të paluajtshme, si shtëpinë, vreshtën dhe ullishten. Këto pasuri ai ua la njerëzve të tij më të afërm, vëllait Aleksit (Allesius), një motre, dhe nipit të tij (me siguri djalit të Aleksit). Në zbatimin e testamentit të kësaj pasurie që zgjati për shumë vite, përmendet në vitin 1405 si prokurator edhe një farë dom Pjetri i biri i Andresë nga Drishti (*dompnus Petrus filius Andree Martini de Drivasto*) dhe dom Aleki i Pellinit nga Drishti (*dompni Allesij q. Pellini de Drivasto*). Përveç pasurive të patundshme dom Mihael Barba Bianca (Michiel barba bianca) kishte edhe një breviar, të cilin ia lë me testament një personi të quajtur po ashtu Mihael (Michiel).⁹⁸

Epidemia e murtajes nuk iu nda krahinës së Raguzës por edhe zonave përreth për shumë kohë dhe shpërthente në mënyrë të papritur herë pas here. Kështu viktimat e saj kemi dhe në vitin 1391, ndër të cilat shënohen edhe drishtjanë. Gjatë këtij viti nga rënia e kësaj sëmundjeje mesa duket si viktimitë të saj kemi të dokumentur në Dubrovnik vdekjen e dom Alexius Barloth nga Drishti. Në lidhje me vdekjen e tij ka njoftime në lidhje me lëniet e testeve tek dy persona, i vëllai i tij Zorzi dhe tek një person po nga Drishti me emër dom Pjetri i biri i Nikollës (*dom Piero fiol de Nicola de Drivasto*)⁹⁹, i cili mesa duket në atë kohë jetonte në Raguzë. Dom Pjetri i biri i Nikollës nga Drishti (*Dom Piero fiol de Nicola de Drivasto*) ishte njëkohësisht edhe i anëtar i vëllazërisë së Shna

⁹⁴ *Statutet dhe Urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit* (Statuta et Ordinationes Capituli Ecclesiae Cathedralis Drivastensis). Dr. Musa Ahmeti dhe Dr. Etleva Lala, Tiranë: OMBRA GVG, 2009, f. 61; shih më tej edhe: AAlb. II, nr. 237.

⁹⁵ M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens...*, f. 52.

⁹⁶ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 368.

⁹⁷ AAlb. II, f. 292. (nr. 391, ref. 1.)

⁹⁸ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 368.

⁹⁹ Po aty.

Ndout (Antunini) i shënuar në regjistrin e kësaj vëllazërie me emrin presbiteri Pietri nga Drishti (*prb. Piero de Drivast*) dhe mund të jetë identik me dom Pjetër Spanin, të birin e Nikollë Spanit nga Drishti (*dompnus Petro Span qu. Nichole Span de Drivasto*), të përmendur në vitin 1402 në regjistrin e kësaj vëllazërie.¹⁰⁰

Alexius Barloth kishte shënuar në testamentet e tij edhe Marushen (Marussa) që ishte një e afërme e një personi me emër dom Nikolla nga Drishti (*Marussa parente de dom Nicola de Drivasto*), i cili ishte paraqitur si dëshmitar testamenti në vitin 1390.¹⁰¹ Ky dom Nikolla nga Drishti mund të jetë identik me dom Nikollë Spanin që përmendëm më sipër.

Gjatë viteve 90-të të shek. XIV në vëllazërinë Antunini përmendet edhe dom Gjitanin nga Drishti (*dom Gittan de Drivasto*).¹⁰² Gjatë fundit të shek. XIV osmanët po kërcënonin Drishtin dhe si rrjedhim prej aty ikën, me sa duket, shumë banorë dhe klerikë, sepse në vitin 1399 në Raguzë ndeshim një koloni të madhe priftërinjsh drishtjanë, të cilët ishin larguar për shkak të rrezikut turk.¹⁰³ Ndër klerikë të tjerë drishtjanë mund të përmendet këtu Pjetër Lepore nga Drishti, i biri i Nikollë Zogit (*Petrus Lepore, filius Nicholay Zoch de Drivasto*), i cili ishte prift dhe shërbyes kishtar (kustod) në kishën e Shën Mërisë së Madhe të Raguzës (*ecclesia S. Marie Maioris de Ragusio*) dhe ka jetuar në Raguzë gjatë periudhës 1399-1404.¹⁰⁴

Ndërsa nga fisi Suma kemi dom Pjetër Sumën e lartpërmendur, i cili arrin të bëhet kapelan i Shën Vlashit të Raguzës, lë një testament me anë të së cilit shpërndan një shumë të madhe parash. Mënyra se si i shpërndan Pjetri paratë e lëna dhe shuma relativisht jo e vogël që ai dhuron me testament më datë 6 shtator 1400,¹⁰⁵ e cila është e madhe krahasuar me teste të tjera, është me interes që të shihet edhe më poshtë.

¹⁰⁰ Po aty.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² Po aty.

¹⁰³ Milan Šufflay & Viktor Novak, "Karakteristika të qytetit të Drishtit", në *Statutet dhe Urdhëresat e Kapitullit të Kishës Katedrale të Drishtit* (Statuta et Ordinationes Capituli Ecclesiae Cathedralis Drivastensis). Dr. Musa Ahmeti dhe Dr. Etleva Lala. Tiranë: OMBRA GVG 2009, f. 48.

¹⁰⁴ AAlb. II, nr. 745, ref. 2; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëll. I (1400-1405), përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë: 1987, nr. 240.

¹⁰⁵ AAlb. II, f. 656.

Kjo shumë parash përbëhet nga dukatë, hyperperë dhe përveç kësaj ai lë edhe shtëpinë e tij dhe sende të tjera, si rroba të shtrenjta etj., që të shiten me qëllim që të plotësohen shumat e testamentit, të cilat do të shpërndaheshin. Duke llogaritur që kanonikëve dhe xhakojevë të Shën Marisë së Raguzës u lë nga tre hyperperë, nëse kemi parasysh që i lë çdo prifti që banon në Raguzë dhe nëpër ishuj nga një hyperper, atëherë kjo shumë në hyperperë është shumë e madhe, dhe e pamundur që të llogaritet.

Përveç shumë së pallogaritshme të hyperperëve dom Pjetri lë me testament edhe shumë dukatë që kanë vlerë më të madhe se hyperperi. Një dukat ishte i barabartë afërsisht me 3 hyperperë në atë kohë.¹⁰⁶ Të gjitha këto para ai ua lë klerikëve të Raguzës dhe disa kishave atje, përfshirë këtu edhe kanonikët e Shën Gjergjit dhe të Shën Mërisë së Drishtit që ishin shumë larg nga Raguzë. Pastaj disa gjëra u lë edhe anëtarëve të familjes, nënës dhe vëllezërve të tij në Drisht. A bëhet fjalë këtu për Pjetër Sumën e lartpërmendur, kjo nuk del në pah, pasi mbiemri i klerikut nuk përmendet

Gjatë vitit 1400 kemi të dokumentuar dom Pjetrin nga Drishti (*dompnus petrus de driuasto*), i cili është dëshmitar për testamentin e Savës, gruas së Jakobit, lëshuar në Dubrovnik më 8 prill 1400.¹⁰⁷ Në Raguzë në shfaqet edhe at Margariti nga Drishti, i cili ishte larguar nga kuvendi i tij në vitin 1401, dhe ndeshet në Dubrovnik në vitin 1406.¹⁰⁸ Sigurisht lista e klerikëve të Drishtit nuk mbaron këtu, por në lidhje me praninë e tyre në Raguzë menduam që këtë artikull të trajtojmë sa më sipër.

Klerikët nga Baleci

Në Raguzë përmenden edhe shumë klerikë të ardhur nga qyteti i vogël i Balecit (*Balegio*, *Baleco*) në afërsi të Shkodrës. Nga kjo qytezë përmendet në veçanti shpeshherë, duke filluar nga viti 1370 deri në vdekjen e tij rreth vitit 1400, një klerik i quajtur Benku nga Baleci (*presb. Bencho de Bales* ose *Dompnus Benchus de Ballegio*), i cili mesa

¹⁰⁶ Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417, përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Tiranë: 1977, f. 223.

¹⁰⁷ *Dokumente të Shek. XV...*, vëll. I, nr. 240.

¹⁰⁸ E. Lala, "Klerikët Shqiptarë ...", f. 15.

duket vinte nga një familje e fisme.¹⁰⁹ Në Raguzë ai mblidhte të dhjetat dhe prodhimet e hershme (primiceve) për kishën e Shën Marisë.¹¹⁰ Ai duket se ishte i njohur aty, pasi në vitin 1372 bëhet sakrist i Katedrales së Raguzës dhe më vonë është i dokumentuar si kapelan i zhupës së Brennos, me emrin “don Bencho de Breno”¹¹¹ Për shkak të moshës së thyer njihej edhe me emrin dom Benku plaku (*don Bencho Vechio*).¹¹²

Dom Benku ka lënë në Raguzë edhe një testament, të cilin e kishin bërë dy klerikë të tjerë, mesa duket sivëllezër të urdhrit dominikan (predikues) dom Bosiamiloste dhe dom Jon Longo nga Durrësi. Përfituesit e sendeve të tij të lëna me testament ndër të tjerë ishin vëllezërit biologjik të vetë dom Benkut, Dobroslavi¹¹³, Pal Markosi dhe Marku, si dhe sivëllezër të tjerë të urdhrit dom Pjetër Vendramin nga Drishti dhe Fra Johani Prior i Predikatarëve (dominikanëve).¹¹⁴ Disa vite më vonë, më 19 maj 1404 dom Benku (*don Bencho de Balleza*) shfaqet edhe në testamentin e klerikut shqiptar dom Mark Kaputapit (*don Marco Caputapis*) këtë radhë si një ndër përfituesit e gjërave të lëna pas.¹¹⁵

Në Raguzë përmendet në veçanti vëllai i tij, Dobroslavi (Dobrosavus), i cili në vitin 1388 del edhe si Dobroslavi, i vëllai i dom Benkut nga Baleci që ishte kastald i vëllazërisë së Zotit të Shenjtë (*Dobroslauus frater dompni Benchi de Balegio castaldus fratriglie s. Domini*) që ishte një vëllazëri flaxhelantësh, e quajtur edhe si “*fraternitas verberatorum*” ose si “*fraternitas fuscatorum*”.¹¹⁶ Përsa i përket këtyre vëllazërive flaxhelantësh mund të thuhet se e kanë origjinën që në shek. XIII dhe ishte një lëvizje laikësh të krishterë që e fshikullonin veten si shenjë pendese për mëkatet e tyre dhe fshikullimi ishte edhe si ritual pastrimi nga këto mëkate. Vetë fjala *flagellum* don të thotë kamxhik. Nuk përjashtohet mundësia që lëvizje të tilla mund të kenë ekzistuar edhe në

¹⁰⁹ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 369.

¹¹⁰ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV ...*, vëll. I (1400-1405), nr. 35; Edmond Malaj, “Baleci në Mesjetë”, në *Studime Historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2016, f. 43.

¹¹¹ AAlb II, nr. 635, shën. 3.

¹¹² Po aty.

¹¹³ E. Malaj, “Baleci në Mesjetë ...”, në *Studime Historike*, f. 43.

¹¹⁴ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV ...*, vëll. I (1400-1405), nr. 37.

¹¹⁵ Po aty, nr. 436.

¹¹⁶ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 369.

trojet shqiptare gjatë Mesjetës, madje edhe vetë në qytetin e Balecit, i cili përveç se qytet, njihet edhe si ipeshkvi gjatë shek. XI-XV.¹¹⁷

Gastaldi kishte funksionin e administratorit të një shoqërie apo vëllazërie në këtë rast dhe si të tillë na shfaqen edhe të tjerë. P. sh. Në vitin 1390 del në dokumente si gastald edhe një nip i dom Benkos, i biri i të vëllait Dobroslavit. Ai ishte dom Dominiku, i biri i Dobroslavit, këpucarit nga Baleci (*dompnus Doininichus filius Dobroslavi caligarii de Balegio*).¹¹⁸

Klerikët nga Pulti dhe Sapa

Nga Pulti, të cilin nëpër dokumente e gjemë me emrat *Polatum*, *Pilot* janë të dokumentuar gjithashtu disa klerikë. Si të parin mund të përmendim presbiterin Gjergj nga Pulti, (*presb. Georgius de Polato*), i cili në vitin 1373 ishte tashmë i vdekur dhe në zbatimin e dokumentit përmendet edhe vëllai i tij dom Pjetri.¹¹⁹ Ndërsa për vitin 1383 përmenden presb. Bencho de Pollato dhe presb. Georgius de Pollato, i cili mbase është identik me priftin Georgius Grubi nga Pulti (presb. Georgius Grubi) që në vitin 1398 bëri testamentin e tij.¹²⁰ Në vitin 1354 përmendet Át Frangu i Zi nga Sapa.¹²¹

Klerikët nga Spasi

Nga Spasi presb. Johannes de Spasso, i cili vdes në vitin 1381 dhe në një testament në lidhje me të përmendet edhe një nip i tij presbiteri Jon de Belica që ishte djali i së motrës të quajtur Bencha.¹²² Ndër klerikët e Spasit, i cili dokumentohet gjithashtu në Raguzë hasim edhe klerikun e ashtuquajtur Gjoni i Zi, i cili për shkak të përshtypjeve të gabuara tek Kuria, në vitin 1370 nga papa emërohet si ipeshkëv i Arbërit.¹²³ *Gjoni i zi* kishte qenë më parë dominikan dhe ishte mik i Gjonit, kryeipeshkvit të

¹¹⁷ Rreth historisë së qytetit të Balecit dhe ipeshkëvisë së tij shih: E. Malaj, “Baleci në Mesjetë...”, në *Studime Historike*, f. 27-48.

¹¹⁸ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 369.

¹¹⁹ Po aty, f. 368.

¹²⁰ Po aty, f. 368-369.

¹²¹ E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 14.

¹²² I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 369.

¹²³ M. Shuflaj, *Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke ...*, f. 77.

Tivarit. Ai ishte nga familja e panjohur Lursi, apo Lourlis, dhe kishte lindur mesa duket në Spas të bregut të Drinit.¹²⁴ Siç del nga një dekret i papës Gregor XI të vitit 1376,¹²⁵ ky ipeshkëv u dëbua nga ipeshkvi që ishte zgjedhur nga kapitulli, i cili ishte një françeskan, i quajtur Demetrius Nesa, të cilin e favorizonte familja dinastike e Topiajve dhe që më vonë fitoi merita shumë të mëdha për dorëzimin e qytetit të Durrësit, venedikasve.¹²⁶ Gjoni i Zi rrinte herë pas here në Raguzë dhe më 22 prill të vitit 1380, ai që konsiderohej edhe si “zoti ipeshkëv i Arbrit” merr nga Këshilli i Vogël një dhuratë prej 4 dukatësh.¹²⁷

Por, kur më në fund Gjoni i Zi u dorëzua (d.m.th. nuk u përpoq më), Kuria zgjodhi në vitin 1391 si ipeshkëv të Arbrit, Gjonin (*Johannes*) nga Trieste, i cili, siç duket, më të shumtën e kohës që i detyruar të qëndronte në Kotorr (1397). Më tej Gjoni i Zi u mundua të bëhej ipeshkëv edhe në dioqezën e afërme të Lezhës, dhe për këtë u ndihmua edhe nga kryeipeshkvi i Tivarit (Gjoni i lartpërmendur), i cili për këtë ndihmë kishte marrë prej këtij edhe para. Dominiku, që ishte bërë ipeshkëv i Lezhës nga papa Urbani V (1369), në vitin 1373 u detyrua të arratisej¹²⁸ nga Lezha përballë pushtetit laik (*potentia laicalis*) që ishin padyshim Dukagjinët.

Më tej në Lagosta gjejmë në funksionin e noterit presbiteranin Gregor Andrean nga Arbëria (*Gregorius Andree de Albania*) (1347) që ishte prift nga Spasi (1350-1353), i cili me sa duket më vonë (1376) shkoi e jetoi në qytetin e Raguzës.¹²⁹

¹²⁴ *Hierarchia Catholica Medii Aevi sive Summorum Pontificum*, S. R. E. Cardinalium, Ecclesiarum Antistitum series. Ab anno 1198 usque ad annum 1431 perducta. E documentis Tabularii praesertim Vaticani collecta, digesta, edita per Conradum Eubel, S. Theol. Doct. Ord. Min. Conv. Definitorem Generalem olim Apostolicam apud S. Petrum de Urbe Poenitentiarum. Editi altera. Sumptibus et Typis Librariae Regensbergianae. Monasterii MDCCCXIII, f. 83. Në vitin 1376 në Raguzë përmendet “don Gjegi Nigro nga Spasi” (*don Georgius Nigro de Spaso*).

¹²⁵ A. Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum ...*, 1, nr. CCCCL; M. Shuflaj, *Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke...*, f. 77.

¹²⁶ Demetrius Nesa qëndroi në postin e tij si ipeshkëv deri në vdekje, në vitin 1393. M. Shuflaj, *Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke...*, f. 77.

¹²⁷ Po aty, f. 78.

¹²⁸ “*Episcopo Drivastensi, ut Dominum episcopum Lessiensem (al. Lessensem) Restituat, expulso Ioanne dicto Nigro intruso.*” A. Theiner, *Vetera Monumenta Slavorum ...* 1, nr. CCCLXXVII.

¹²⁹ Po aty, f. 78.

Klerikët nga Durrësi

Ndër klerikët shqiptarë në Raguzë një vend të rëndësishëm zënë ata nga Durrësi. Në gjysmën e parë të shek. XIV kemi të dokumentuar edhe fratin françeskan at Ndreu (Andrean) nga Durrësi, i cili kishte ikur për në Dubrovnik në vitin 1345. Nëpër dokumente në vitin 1347 rezulton si prift i thjeshtë, ndërsa në vitet 1371 dhe 1381 është i dokumentuar si gardian në “Male Braće”¹³⁰. Për vitin 1349, studiuesja E. Lala përmend Gjini Shqiptarin pa na dhënë detaje të tjera rreth tij, kurse në vitin 1355 përmendet atë Minori nga Durrësi që ishte vendosur në Kuvendin Françeskan të Raguzës, për të cilin thuhet që ishte arratisur nga trojet arbërore dhe kishte udhëtuar në këmbë për rreth tri javë nëpër viset e bregdetit dalmatin, deri sa kishte arritur në kuvend i lodhur e i dërrmuar.¹³¹ Një vit më vonë më 1356 përmendet sërish at Minori tjetër nga Durrësi, por që sipas E. Lalës, nuk kishte asgjë të përbashkët me at Minorin e lartpërmendur. Ky at Minori kishte arritur të emërohej provincial në vitet 1377-1395 dhe në këtë kohë ishte edhe mësues i teologjisë në Gjinnazin e Dubrovnikut.

At Ndreu nga Durrësi është një tjetër at dominikan që gjendej në Raguzë gjatë kësaj kohe. Ai jetonte në Dubrovnik që nga viti 1369 dhe disa vite më vonë bëhet prior i Kuvendit të Dominikanëve për një kohë të shkurtër, rreth një vit (nga 8 janari i vitit 1376 deri më 10 janar 1377).¹³² Sipas E. Lalës, ai ishte arratisur nga Durrësi që në vitin 1369 si rrjedhojë e presioneve nga kleri ortodoks, dhe kishte lënë atje gjithë çfarë kishte, për të “shpëtuar kokën”.¹³³ Kontradiktat që ekzistonin në Durrës ndërmjet kishës latine dhe asaj bizantine, njihen tashmë dhe duket se edhe ky klerik ishte viktimë e tyre. Ai është i dokumentuar në Dubrovnik deri më 15 tetor të vitit 1400, vit ky kur ai vdes.¹³⁴

Në vitin 1383 kemi të dokumentuar si kryeipeshkëv të Raguzës Andrean nga Durrësi.¹³⁵ Sipas burimeve të tjera ai u bë kryeipeshkëv në

¹³⁰ E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 14.

¹³¹ Po aty.

¹³² Po aty, f. 14-15.

¹³³ Po aty, f. 15.

¹³⁴ Po aty.

¹³⁵ G. Luccari, *Copioso Ristretto degli Annali di Rausa...*, f. 174.

vitin 1387 dhe i përkiste Urdhrit Dominikan.¹³⁶ Jemi të mendimit që nuk është i njëjti person, të cilin e përmendëm më sipër me të njëjtin emër.

Një personalitet shumë i lartë kishtar nga qyteti i Durrësit dhe që u arratis nga ky qytet është frati dominikan nga dera e njohur fisnike e Topiajve, Domeniku, i cili kishte arritur deri në shkallën e lartë të hierarkisë kishtare, në atë të kryepeshkvit. Dominik Topia (1336-1374), vëlla i Tanush Topisë¹³⁷ dhe mesa duket xhaxha i Karl Topisë, iu dedikua jetës klerikale dhe karriera e tij e çuditshme duhet të përshkruhet këtu për hir të rëndësisë shumë të madhe politike në biologjinë e kësaj familjeje.¹³⁸ Dominiku më vonë u bë edhe ipeshkëv i Korculës dhe i Stanjos (Episcopus Corcyrensis et Stagnensis 1350-1367)¹³⁹, duke u mbështetur në fuqinë e familjes së tij dhe të Mbretit të Hungarisë Ludvig I Anzhu, hartoi plane të mëdha politike.¹⁴⁰

Françeskani at Pali nga Durrësi është një tjetër klerik që përmendet më 1372, vit në të cilin ishte emëruar si bashkëprior në Kuvendin Françeskan, kurse në vitin 1385 gjejmë informacione për at Mhillin nga Durrësi i cili ishte vendosur në Dubrovnik që në vitin 1383.¹⁴¹ Po në vitin 1372, në radhën e priorëve të Kuvendit Dominikan të Dubrovnikut ndeshim një klerik të lartë shqiptar nga Durrësi, at Palin. Për këtë figurë disa të dhëna na i sjell studiuesja E. Lala.¹⁴²

Ati dominikan Pali nga Durrësi, tregoi përkushtim dhe nderim të veçantë për urdhrin e predikatoreëve (dominikanëve), ndërsa në anën tjetër ishte shumë i respektuar dhe nderuar te dubrovnikasit si tek ata të shtresës së lartë fisnike qytetare, por edhe te qytetarët e thjeshtë. Ai “arratiset” nga qyteti i lindjes natën e 13 prillit të vitit 1372 me një galerë, përmes detit Adriatik për në Dubrovnik, për shkak të një konflikti për çështje pronash me një familje sllave, Mrkoviq, që jetonin në Durrës.

¹³⁶ *Status Cleri et Animarum Dioecesis Ragusinae ineunte anno domini 1855*, Venetiis: Typis f. A. Perini 1855, pa nr. faqeje.

¹³⁷ AAlb. I, nr. 802.

¹³⁸ M. Shuflaj, *Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke ...*, f. 81.

¹³⁹ *Illyrici Sacri tomus sextus*. Ecclesia Ragusina cum Suffraganeis, ed Ecclesia Rhiziniensis et Catharensis. Auctore Daniele Farlato. Presbytero Societatis Jesu et Jacobo Coletolo olim ejusdem societatis Alumno. Venetiis, MDCCC. Apud Sebastianum Coleti. Superiorum permissu, ac privilegio, f. 371; AAlb. I, nr. 802, ref. 1.

¹⁴⁰ M. Shuflaj, *Situata të Kishës në Shqipërinë paraturke ...*, f. 120.

¹⁴¹ E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 15.

¹⁴² Të dhënat në vazhdim për atin domenikan Pali nga Durrësi vijnë sipas: E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 15.

Meqenëse gjatë shërbimit në kuvendin e dominikanëve në Durrës, kishte mbajtur lidhje të ngushta me atë të Dubrovnikut, për shkak të cilësive të veçanta dhe përgatitjes profesionale, më 16 tetor 1373 emërohet prior i Kuvendit dominikan të Dubrovnikut.¹⁴³

Tjetër klerik, i cili na shfaqet disa herë nëpër dokumentet raguzane është at Teodori nga Durrësi, i cili i përkiste Urdhrit të Dominikanëve. Ai ishte arratisur në Dubrovnik më 9 maj 1371, për shkak të kërcënimit të një familjeje ortodokse durrsake që ishte në lidhje fafëfisnore me “papasin” ortodoks grek të këtij qyteti. Ai shpejt ambientohet me rrethin dhe me kushtet e reja të jetës klerikale në kuvendin e ri dominikan, ku ndeshet më 11 shkurt të vitit 1376. Ndërsa një vit më vonë, më 12 janar 1377 ai bëhet prior i këtij urdhri, në kishën e Shën Jakobit, jashtë mureve të qytetit të Dubrovnikut,¹⁴⁴ pasi më parë, më 15 janar 1376, kishte qenë vikar i fretërve dominikan të Raguzës¹⁴⁵. Ai përmendet edhe në dokumente të tjera, p. sh. më 18 nëntor të vitit 1378 me shqyrtim të Këshillit të Rogatëve ai dëbohet nga qyteti i Raguzës së bashku me një frat tjetër dominikan që quhej Pal (*Frater Paulus ordinis Predicatorum*). Dhjetë vite më vonë, më 10 shtator 1388 ata të dy përmenden përsëri si rezident në Kuvendin Dominikan të Raguzës.¹⁴⁶ Jemi të mendimit se këtu bëhet fjalë gjithnjë për të njëjtin frat Teodor nga Durrësi.

Një tjetër figurë historike që i përket urdhrit dominikan është edhe Nikolla nga Durrësi. Pas një konflikti që kishte pasur në qytetin e tij me njërin nga fisnikët e njohur shqiptarë të familjes Topia, at Nikolla nga Durrësi, arratiset prej aty dhe në shtator të vitit 1387 arrin në Dubrovnik dhe strehohet atje.¹⁴⁷ Në atë kohë Topiajt ishin sundimtarët e Durrësit. Ai dëshmon vetë që kishte mbërritur në Kuvendin e Dominikanëve në Dubrovnik i veshur si lypsar.¹⁴⁸ Më 23 qershor të vitit 1390 është i dokumentuar si prior i këtij Kuvendi, funksion që e ushtron deri në fund të janarit 1400 dhe pas këtij viti, mesa duket i pakënaqur nga zhvillimet brenda Kuvendit të Dominikanëve në Dubrovnik, duket se kaloi në një

¹⁴³ Po aty.

¹⁴⁴ Po aty.

¹⁴⁵ “Anno 1376, 15 ianuarii, “frater Theodorus de Durachio, vicarious fratrum Predicatorum de Ragusio memoratur”. AAlb II, nr. 323, ref. 2.

¹⁴⁶ AAlb II, nr. 323, ref. 2.

¹⁴⁷ E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 15.

¹⁴⁸ Po aty.

urdhër tjetër, në urdhrin e françeskanëve.¹⁴⁹ Data e kalimit është e panjohur, por sipas E Lalës, ai ndeshet nëpër dokumente të datës 22 tetor të vitit 1427 si “shumë i nderuar frati Nikolla nga Durrësi, ministër i Provicës së Dalmacisë, së [fretërve] minorit” (“*venerabilis frater Nicolaus de Durachio, minister Provincie Dalmatie ordinis minorum*”), pra në një pozitë drejtuese gjë që është një tregues i mirë për reputacionin që ai gëzonte në radhët e klerit që jetonte e vepronte në Dubrovnik.¹⁵⁰ Ka mundësi që ai edhe të mos jetë i njëjti person, sepse nga viti 1387, ku at Nikolla shfaqet si dominikan e deri në vitin 1427, ku ai shfaqet si frat françeskan kanë kaluar tashmë 44 vite.

Frati Gjoni nga Durrësi (*fra Johannes de Durachio*) ishte një shembull tjetër suksesi në hierarkinë klerikale. Gjoni nga Durrësi ishte frat dominikan, i cili arriti të bëhej prior i Kuvendit të Dominikanëve (*prior conventus fratrum predicatorum*) në Raguzë¹⁵¹. Emri i tij përmendet kryesisht në vitin 1400, në shumë dokumente në lidhje me testamente të ndryshme, që kishin të bënin kryesisht me shuma të hollash të marra apo të dhëna nga ai, apo të lëna atij ose kuvendit të dominikanëve në Raguzë.¹⁵²

Një prior tjetër i Kuvendit Françeskan në Dubrovnik është edhe at Leka nga Durrësi në vitin 1382, i cili ishte arratisur nga kuvendi i tij në Shqipëri në vitin 1378.¹⁵³ Sipas E. Lalës, me mjaft interes është edhe jeta e françeskanit tjetër durrsak, at Nikollës, i cili e zëvendëson në pozitën e priorit at Lekën, bashkëkombësin dhe bashkëqytetarin e tij. At Nikolla kishte mbërritur në Dubrovnik në vitin 1396 pas konfliktit me familjen fisnike shqiptare të Topiajve dhe në vitet 1432, 1437 dhe 1445 e gjejmë si provincial në Kuvendin Françeskan “Male Braće.”¹⁵⁴

Më vonë bëhet fjalë sërish për një at Andrea nga Durrësi porse këtu nuk është fjala për të njëjtin person që përmendëm më lart. Ky është Andrea nga Durrësi (*Andrea de Dyrrhachio*), i cili në vitin 1387 bëhet kryeipeshkëv i Raguzës, i njohur si *Andreas IV Archiepiscopus*

¹⁴⁹ Po aty.

¹⁵⁰ Po aty.

¹⁵¹ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të Shek. XV*, vëll. I. (1400-1405) nr. 27.

¹⁵² Shih për këtë *po aty*, shënimi 1.

¹⁵³ E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 15.

¹⁵⁴ Po aty.

*Ragusinus*¹⁵⁵. Ai kishte qenë që nga viti 1379 provincial i urdhrit dominikan për të gjithë Dalmacinë.¹⁵⁶

Me angazhimin e tij në gusht të vitit 1391 u themelua në Raguzë katedra e Shën Pjetrit,¹⁵⁷ dhe në këtë katedër, krahas tij përmenden edhe klerikët shqiptarë *Petrus de Suinis de Driuasto* dhe *Petrus Caputapis de Albania*.¹⁵⁸ Kryeipeshkvi Andrea gjatë riorganizimit të kolegjit priftëror bën Pjetër Svinin e Drishtit (*Petrus de Svinis Drivastensis*), Pjetër Kaputapin e Arbërisë (*Petrus Caputapis de Albania*) dhe një farë Pjetri i Nicolai de Albis de Ragusio, të cilët që të tre jetonin në Raguzë, prokuratorë të vëllazërisë së Raguzës.¹⁵⁹

Gjatë kohës, kur Andrea Durrsaku (*Andrea de Duracio*) ishte kryeipeshkëv i Raguzës aty ra murtaja dhe bëri kërdinë, dhe sipas dëshmive të kohës vdisnin 600 deri 800 vetë në ditë, e kështu qyteti i Raguzës shkatërrohet pothuajse tërësisht nga kjo epidemi.¹⁶⁰ Sipas Jahja, Drançollit klerikët shqiptarë të lartpërmendur (*Andrea i Durrësit, Petrus de Suinis i Drishtit dhe Petrus Caputapis*) shquhen për vepra të shkëlqyeshme humanitare, duke i kthyer ndërtesat e kultit në spitale të mirëfillta në shërbim të njerëzve.¹⁶¹ Një figurë tjetër e rëndësishme kishare është edhe Gjoni nga Durrësi (*Johannes de durachio*), i cili ishte prior i dominikanëve të Raguzës,¹⁶² për të cilin do të flasim edhe më poshtë. Në vitin 1387 në burime arkivore gjejmë fare pak të dhëna për at Sergjin nga Durrësi.¹⁶³

Sipas Shuflait, kuvendi i Dominikanëve në Dubrovnik, përbëhej tërësisht nga fretër shqiptarë, me përjashtim të një frati që ishte nga Trogiri i Kroacisë. Në vitin 1394 përmendet si prior i Kuvendit frati Pali

¹⁵⁵ *Illyrici Sacri. tomus sextus*. Ecclesia Ragusina cum Suffraganeis, ed Ecclesia Rhiziniensis et Catharensis. Auctore Daniele Farlato. Presbytero Societatis Jesu et Jacobo Coletto olim ejusdem societatis Alumno. Venetiis, MDCCC. Apud Sebastianum Coleti. Superiorum permissu, ac privilegio, f. 140; shih edhe: Jahja Drançolli, *Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë Mesjetës*. Zagreb: Misioni Katolik Shqiptar Kroaci, 2008, f. 133.

¹⁵⁶ D. Farlati, *Illyrici Sacri VI*, f. 141.

¹⁵⁷ *Po aty*, f. 141

¹⁵⁸ J. Drançolli, *Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes...*, f. 133.

¹⁵⁹ AAlb. II, nr. 472.

¹⁶⁰ J. Drançolli, *Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes...*, f. 305.

¹⁶¹ *Po aty*.

¹⁶² *Dokumente për historinë e Shqipërisë të Shek. XV...*, vëll. I (1400-1405), nr. 27.

¹⁶³ E. Lala, "Klerikët Shqiptarë ...", f. 15.

nga Durrësi (*frater Paulus de Durachio*).¹⁶⁴ Në vitin 1388 përmendet në Raguzë presbiteri Antoni nga Durrësi (*Antonio de Durachio*) për të cilin nuk dimë më tepër.¹⁶⁵

Në vitin 1387 në burime arkivore gjejmë fare pak të dhëna për at Sergjin nga Durrësi. Një prior tjetër i Kuvendit Françeskan në Dubrovnik në vitin 1382 është edhe at Leka nga Durrësi, i cili ishte arratisur nga kuvendi i tij në Shqipëri në vitin 1378.¹⁶⁶ Sipas E. Lalës, me mjaft interes është edhe jeta e françeskanit tjetër durrsak, at Nikollës, i cili e zëvendëson në pozitën e priorit at Lekën, bashkëkombësin dhe bashkëqytetarin e tij. Në Dubrovnik atë Nikolla kishte mbërritur në vitin 1396 pas konfliktit me familjen fisnike shqiptare të Topiajve dhe në vitet 1432, 1437 dhe 1445 e gjejmë si provincial në Kuvendin Françeskan “Male Braće.”¹⁶⁷

Në një dokument të datës 16 dhjetor të vitit 1413 (Dubrovnik) jepen disa emra fretërisht françeskanë shqiptarë ndër të cilët edhe frat Nikolla nga Durrësi, i cili së bashku me ta bënte pjesë në kapitullin e kuvendit françeskan të Raguzës.¹⁶⁸ Këtij françeskani, Senati i Raguzës në vitin 1432 i kërkon të kthejë disa dorëshkrime me vlerë që i kishte huazuar për studim me rastin e ikjes së tij për në Padova të Italisë, ku po mbronte doktoratën.¹⁶⁹ Me interes është të përmendim këtu edhe françeskanin at Andrea nga Durrësi (*frater Andreas de Durachio* siç e shkruan ai vetë emrin¹⁷⁰), i cili kishte ikur nga qyteti i tij në vitin 1429. Në vitin 1438 e gjejmë si provincial në Kuvendin Françeskan “Male Braće” dhe inkuizitor të Urdhrit (*Provincialis ministri & Sacri Inquisitoris*)¹⁷¹, pasi më parë kishte mbrojtur gradën shkencore Doktor nga Shkrimi i Shenjtë,¹⁷² Më vonë at Andrea për periudhën 1445-1450 bëhet ipeshkëv i

¹⁶⁴ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 369.

¹⁶⁵ Po aty.

¹⁶⁶ E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 15.

¹⁶⁷ Po aty.

¹⁶⁸ I. Mahnken, “Beziehungen zwischen Ragusanern ...”, në *Südosteuropa-Forschung*, f. 369.

¹⁶⁹ E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 15.

¹⁷⁰ *Illyrici Sacri Tomus quartus. Ecclesiae Suffraganeae Metropolis Spalatensis. Auctore Daniele Farlato Presbytero Societatis Jesu. Venetiis, MDCCLXIX. Apud Sebastianum Coleti. Superiorem permissu, aq privilegio*, f. 128.

¹⁷¹ Po aty.

¹⁷² E. Lala, “Klerikët Shqiptarë ...”, f. 15.

Senjit (*Andreas Episcopus Seniensis*)¹⁷³ që ishte sufragane e Mitropolisë së Splitit.

Më tej, si klerikë të Durrësit në Raguzë mund të përmendim edhe at Gjonin nga Durrësi (1396-1435) aktiv edhe si "*frater monasterii sancti Dominici fratrum predicatorum Ragusii*"; fratin dominikan shqiptar, at Dhimitër Spanin (1403-1406) dhe presbiterin at Gjergji nga Durrësi,¹⁷⁴ por më gjerë për ta do të flasim në punime të tjera.

Përfundime

Si përfundim mund të themi që prania e klerikëve shqiptarë në Raguzë është shumë e shpeshtë dhe fillon të shfaqet atje që nga shekujt e Mesjetës së Mesme dhe vazhdon deri në shekujt e fundit të Mesjetës së Vonë. Funkcionet e këtyre klerikëve janë nga më të ndryshmet. Duke filluar nga klerikë të thjeshtë e deri tek priorët e kuvendeve dhe bile ndonjëri arrin edhe detyrën e lartë të kryepeshkvit të Raguzës, si rasti i at Andreas nga Durrësi¹⁷⁵, apo rasti i at Dominik Topisë që bëhet ipeshkëv i Korculës dhe Stagnos¹⁷⁶, apo atit françeskan Andreas po nga Durrësi që u bë Ipeshkëv i Senjit.¹⁷⁷

Përkatësia e këtyre klerikëve është e ndryshme. Aty gjejmë presbitera dioqezanë, fretër dominikanë dhe françeskanë. Në veçanti bie në sy prania e dominikanëve të cilët e kishin prejardhjen kryesisht nga Durrësi. Prezenca e tyre e konsiderueshme dhe funksionet e tyre shpeshherë shumë të larta në hierarkinë kishtarë katolike dëshmojnë qoftë për nivelin e lartë të tyre, qoftë për kulturën e lartë kishtarë që ka ekzistuar në Mesjetë në qytetet shqiptare, sepse pa qenë të formuar mirë ata nuk do ta kishin pasur të mundur të depërtonin deri tek postet e priorëve, të ipeshkvijve dhe të kryepeshkvit. Ky formim që i bënte ata të suksesshëm në një vend të rëndësishëm të Evropës mesjetare, siç ishte Republika e Raguzës, dëshmon në mënyrë indirekte edhe për nivelin e lartë të Kishës Katolike në trojet shqiptare.

¹⁷³ D. Farlati, *Illyrici Sacri*, IV, f. 128-129.

¹⁷⁴ E. Lala, "Klerikët Shqiptarë ...", f. 15.

¹⁷⁵ D. Farlati, *Illyrici Sacri* VI, f. 140.

¹⁷⁶ Po aty, f. 371.

¹⁷⁷ D. Farlato, *Illyrici Sacri* IV, f. 128.

*S u m m a r y*THE PRESENCE AND ACTIVITY OF THE ALBANIAN CLERGY IN RAGUSA
DURING THE MIDDLE AGES

This paper deals with the presence of the Albanian Catholic clergy in the Republic of Ragusa during the Middle Ages. The clerics included in this study have been classified according to their origin and listed on a chronological basis. While the cities where they served have been listed according their geographical position from north to south. As for the timeframe, my research was focused in the period from the 13th to the 15th century.

